



Pranuar / Dorezuar Priljezo/Prodato Received/Delivered	26.07.2023	3	viti god year
Organ/Njësia Organ/Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shlopje Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHK	5361/2023		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.804/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.804/2023 të datës 02.06.2023 të ankuesit _____ i përfaqësuar nga Zyra Ligjore _____ kundër Vendimit Nr.08/27-658-2023 i datës 17.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, neni 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.07.2023, mori këtë.

V E N D I M

I. Anullohet Vendimi Nr.08/27-658-2023 i datës 17.05.2023 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ndërsa lëndë kthehet në *rishqyrtim* dhe *rivendosje* tek Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

II. Obligohet Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi si në pikën I të dispozitivit, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ me datë 02.06.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.08/27-658-2023 të datës 17.05.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe ankesave i Sekretariatit të Komisionit

Qendror të Zgjedhjeve, me pretendimet ankimore se i njëjti ka plotësuar kriteret e konkursit që ndërliidhen me të drejtën për të aplikuar në komunën përkatëse si në konkursin e shpallur për pozitën "Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë" nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, (tani e tutje KQZ), me arsyetimin se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e refuzimit të ankesës së tij të datës 19.04.2023 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr.02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve dhe dispozitat e ligjit material dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij ngase nuk ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 09.06.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të KQZ, ndërsa me datë 14.06.2023, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.804/2023, e datës 02.06.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 30.05.2023; Aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese me numër të rastit KO171/18 i datës 20.05.2019; Konkursin e shpallur nga KQZ të datës 30.01.2023; Njoftimi për kandidatin e Suksesshëm i datës 10.03.2023; E-mail i dërguar nga V.B drejtuar L.A i datës 10.03.2023; Vendimi i Kryeshefit Ekzekutiv me numër 02-396-2023 i datës 07.04.2023; Vendim me numër 08/27-658-2023 i datës 17.05.2023; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 09.06.2023; Përgjigja në ankesë e datës 14.06.2023; Vendim për Themelimin e Komisionit me numër 02-184-2023 i datës 20.02.2023; Akt emërim për N.H i datës 24.10.2022; Ndryshim dhe plotësim i akt emërimit për M.M i datës 04.02.2019; Akt emërim për F.L i datës 02.07.2019; Ndryshim Plotësim i Akt emërimit për V.K i datës 04.02.2019; Ndryshim Plotësim i Akt emërimit për Z.S i datës 04.02.2019; Kërkesa për punësim për R.M e datës 06.02.2023; Certifikata e lindjes i datës 03.02.2023; Certifikata e Vendbanimit e datës 03.02.2023; Kopja e letërnjoftimit për R.M; Certifikata mbi denimet penale e datës 03.02.2023; Vendim i lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë me numër ref.6-1534 i datës 20.03.2018; Licencë e lëshuar nga Universiteti i Uludag i datës 09.09.2013; Vërtetim i Kopjes nga Dokumenti Origjinal me numër LPR 767/2023 i datës 02.02.2023; certifikata e studentit; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Balikesir me numër 25-02-0000688; Vërtetim i Kopjes nga Dokumenti Origjinal me numër LPR 766/2023 i datës 02.02.2023; Informatat e Identifikimit të lëshuar nga Universiteti i Uludag; Vlerësimi i performancës 2022 për R.M i datës 12.01.2023; Vlerësimi i performancës 2021 për R.M i datës 06.01.2022; Certifikata e notave me datë 24.03.2021; Certifikata e studentëve; Transkripta e të dhënave të akademisë e datës 02.02.2023; Vendim i lëshuar nga Komuna e Mamushës me numër 23/2023 i datës 03.02.2023; Pasqyra e Llogarisë në Trust për periudhën kohore 01.12.2017 deri 31.01.2023; Certifikatë pjesëmarrje për R.M e lëshuar nga Erasmus+, Kosgeb, Turkish National Agency dhe BFP Kosova; Certifikatë e lëshuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës dhe Accesible Quality Healthcare e datës 07.11.2018; Certifikatë e lëshuar nga USAID, Komisioni rregullativ i Prokurimit Publik, Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal dhe Instituti i Kosovës për Administratë Publike; Certifikatë e arritjes për R.M e lëshuar nga IRI; Vërtetim për pranimin e aplikacionit nga Divizioni i personelit i datës 06.02.2023; Raporti nga Kryesuesi i Komisionit Përzgjedhës mbi përgatitjen e listës së ngushtë e datës 23.02.2023; Kërkesë për punësim e L.A e datës 10.02.2023; Deklaratë e lëshuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; Certifikatë mbi denimet penale e datës 31.01.2023; CV- ja e L.A; Deklarim nga L.A e datës 06.01.2023 (në gjuhën

shqipe dhe sllovene); Ekstrakt nga sigurimi ne Republikën e Sllovenisë (në gjuhën shqipe dhe sllovene); Vërtetim i lëshuar nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve -2023; Vërtetim i lëshuar nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i datës 31.12.2017; Letër rekomandimi i datës 26.03.2021; Letër rekomanduese e datës 10.01.2018; Kontributet në trust e datës 06.04.2022; Shkresë me numër 439 e datës 08.02.2023; Vërtetim për pranimin e aplikacionit nga Divizioni i personelit i datës 10.03.2023; Kopja e letërnjoftimit për L.A; Diplomë e lëshuar nga Kolegji Pjetër Budi" me numër 230 e datës 27.12.2012; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës për L.A; Kërkesë për punësim për I.M; Deklaratë e lëshuar nga KQZ e datës 07.02.2023; Certifikatë e lëshuar nga Alperenler e datës 13.08.2005; Certifikatë e lëshuar nga Alperenler e datës 13.07.2004; Kontratë ndërmjetësimi me agjentë të jashtëm me numër 289 e datës 29.05.2016; Certifikatë e regjistrimit të biznesit me numër 71295737 e datës 29.07.2016; Njoftim për shuarjen e biznesit e datës 23.11.2016 me korrespondencën e bashkangjitur; Certifikatë Trajnimi e lëshuar nga Austrian Development Coorporatiojn Projekti i UE dhe Eorld Vision e datës 16.06.2013; Certifikatë e lëshuar nga Agjencia për Informim dhe Pivatësi e datës 24.08.2021; Certifikatë e lëshuar nga Agjencia për Informim dhe Pivatësi e datës 31.08.2021; Certifikatë e lëshuar nga GUC dhe ITM e datës 09.12.2009(në gjuhën turke dhe anleze); Certifikatë e lëshuar nga GUC dhe ITM e datës 25.04.2009; Çertifikatë e lëshuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike e datës 07.11.2018; Certifikatë e lëshuar nga OSCE e Datës 25.05.2013; Certifikatë e lëshuar nga Akademia Diplomatike e datës 28.11.2018; Diplomë e lëshuar nga Universiteti i Trakya me numër 2778 e datës 01.09.2010; Akt emërim për I.M e datës 01.09.2018; Pasqyra e llogarisë në Trust për periudhën kohore 02.12.2013 deri 06.02.2023; Certifikatë mbi dënimet penale për I.M e datës 03.02.2023; Kopje e letërnjoftimit për I.M; Formulari mbi vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për I.M e datës 13.02.2023; Formulari mbi vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për I.M e datës 31.01.2023; Vendim i lëshuar nga Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë me numër ref.6/817; Certifikatë e emërimit për I.M e datës 14.08.2013; Vërtetim për pranimin e aplikacionit nga Divizioni i personelit i datës 14.02.2023; Raporti nga Komisioni Përzgjedhës për vlerësimin e testeve me shkrim për pozitën KQZ-05/2020 Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë i datës 06.03.2023; Raporti final i rekomandimit nga Komisioni Rekrutues i datës 07.03.2023; Kërkesa për aprovimin e Rekomandimit të Komisionit Përzgjedhës i datës 08.03.2023; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj nga anëtarët e komisionit për L.A; Vlerësimi individual i kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj nga anëtarët e komisionit për R.M; Përmbledhje e vlerësimeve individuale; Renditja përfundimtare e kandidatëve ; Vendimi për anulimin e konkursit me numër 02-396-2023 i datës 07.04.2023; Deklarata nën betim e F.M me numër 09-381-2023 e datës 07.04.2023; E-mail i dërguar nga B.A drejtuar A.D e datës 06.04.2023; Kontrata mbi shfrytëzimin e paluajtshmërisë me qira e datës 08.12.2021; Vërtetim nënshkrimi me numër LPR.nr.256/2021 e datës 08.12.2021; E-mail i dërguar nga V.B drejtuar L.A e datës 23.03.2023; E-mail i dërguar nga L.A drejtuar V.B e datës 28.03.2023; Certifikatë e lëshuar nga Creative për L.A; Transaksionet e konsumatorit për KKFE-KESCO-KPSE për periudhën kohore 01.01.2022 deri 31.12.2023; E-mail i dërguar nga P.R drejtuar B.A e datës 23.03.2023 me korrespondencën e bashkangjitur; E-mail i dërguar nga L.A drejtuar V.B e datës 28.03.2023; Ankesë drejtuar Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave me numër 09-446-2023 e datës 19.04.2023; E-

mail i dërguar nga V.B drejtuar L.A e datës 07.04.2023; Vendimi i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave me numër 08/27-658-2023 e datës 17.05.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit duhet të kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *rivendosje* tek organi i njëjtë, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës të parashtuara nga palët në procedurë, ka gjetur se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 30.01.2023 ka shpallur konkursin publik për gjashtë (6) pozita të lira, prej tyre edhe pozitën me shifër "KQZ-05/2023-Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë", ndërsa sipas shkresave të lëndës konstatohet se në këtë konkurs për pozitën e lartcekur ka aplikuar edhe kandidati i cili sipas Njoftimit të datës 10.03.2023 të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve rezulton se pas përfundimit të procedurës së rekrutimit i njëjti është shpallur kandidatë i suksesshëm për pozitën "Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë" pasi që ka arritur të fitoj 82.2 pikë.

Tutje, Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përmes Vendimit me numër 02-396-2023 të datës 07.04.2023 ka anuluar konkursin për pozitën "KQZ-05/2023-Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë", me arsyetimin se sipas nenit 1.2 të Ligjit Nr.02/L-37, për përdorimin e gjuhëve, në nivelin komunal gjuhët tjera të bashkësisë si gjuha turke, boshnjake dhe rome janë gjuhë në përdorim zyrtarë të cilat kandidati i suksesshëm nuk i njeh, si dhe mbi bazën e "Deklaratës nën Betim" nga F.M të pranuar me datën 07.04.2023 nga Kryeshefi Ekzekutiv i Sekretariatit të KQZ-së sipas së cilës deklaratë ankuesi pavarësisht që ka marr banesë me qera nga deklaruesi F.M, i njëjti asnjëherë nuk ka banuar në Mamushë.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin numër 02-396-2023 të datës 07.04.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka parashtuar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me pretendimet ankimore se sipas konkursit të datës 30.01.2023 për pozitën me shifër "KQZ-05/2023" njohja e gjuhëve të tjera zyrtare konsiderohet si përparësi dhe e njëjta nuk ka qenë obligative, aplikacioni ka qenë i kompletuar sipas kriterëve të përcaktuara të konkursit me dëshminë se vendbanimi ti tij është Komuna e Mamushës, ndërsa ka theksuar faktin se Vendimi numër 02-396-2023 i datës 07.04.2023 i Kryeshefit Ekzekutiv ka qenë në kundërshtim me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative pasi nuk ka përmbajtur udhëzimin për këshillën juridike, me kërkesën se parashtrimi i ankesës duhet të pezullojë prodhimin e pasojave juridike të akteve që goditen.

Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave përmes Vendimit me numër 08/27-658-2023 të datës 17.05.2023 e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 19.04.2023 ndërsa ka lënë në fuqi Vendimin me numër 02-396-2023 të datës 07.04.2023 të Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për anulimin e konkursit në fjalë në të cilin ankuesi kishte rezultuar kandidatë i suksesshëm, me arsyetimin se ankuesi nuk ka pasur pretendim ankimor në lidhje me çështjen faktike të ngritur nga deklarata e M.F në cilësinë e qiradhënësit të ankuesit, por vetëm ka ngritur pretendimin për mos shkëputje të kontratës së qirasë, kurse lidhur me pretendimin se njohja e gjuhëve të tjera zyrtare është përparësi dhe nuk është e obligueshme Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka gjetur se është pretendim i qëndrueshëm.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar shpalljen e konkursit të datës 31.01.2023 për pozitën "Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë" ku ndër të tjera është paraparë si kriter që "Kandidatët të cilët aplikojnë për pozita Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve (ZLKGJ) duhet të jenë persona me të drejtë vote në komunitet e tyre përkatëse", nga rrjedh se kandidatët për pozitën e lartcekur duhet të jenë persona me të drejtë vote në komunën përkatëse, pra të jenë të evidentuar në listën e votuesve të komunës përkatëse e cila mirëmbahet dhe aranzhohet nga KQZ, sikurse përcaktohet me nenin 7 paragrafi 7.1 dhe 7.3 të Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës theksohet së "7.1 KQZ-ja mban Listën e Votuesve dhe siguron që Lista e Votuesve është e saktë dhe e azhuruar, dhe e njëjta përmban: a) ekstraktin më të vonë në dispozicion nga Regjistri Qendror Civil i të gjithë votuesve me të drejtë vote të cilët janë regjistruar si qytetar të Kosovës sipas Ligjit për Shtetësinë; b) të gjithë votuesit me të drejtë vote jashtë Kosovës të cilët në mënyrë të suksesshme kanë aplikuar për votim jashtë Kosovës. 7.3 Për konfirmimin e të drejtës për votim, KQZ-ja ka qasje në regjistra, të dhëna për vendbanim dhe të dhëna të tjera zyrtare.", mirëpo nga shkresat e ofruara në cilësi të provave të dërguara në Këshill përmes shkresës së datës 14.06.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bashkangjitur edhe kopjen e letërnjoftimit të ankuesit me Nr. Personal:1171563697 dhe numër të ID2020637 i lëshuar me datë 13.12.2021, sipas së cilit dokument konstatohet fakti se vendbanimi i ankuesit është në Mamushë, prandaj në rrethanat e rastit konkret Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka vepruar gabimisht kur ia ka falur besim vetëm njëres provë, respektivisht deklaratës së dhënë nga personi F.M, rrjedhimisht nuk ka arritur të konstatojë drejtë gjendjen faktike, pasi që sipas kopjes së letërnjoftimit të ankuesit të lëshuar me datë 13.12.2021 dëshmohej se vendbanimi i ankuesit është në Mamushë, prandaj mbështetur në dispozitat e nenit 7 paragrafi 7.1.a dhe 7.3 të Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, duke qenë se Komisioni i Ankesave është organ që vepron në kuadër KQZ-së ka mundur të kërkojë nga personat përgjegjës brenda institucionit që të bëjë verifikimin nëse ankuesi sipas letërnjoftimit të paraqitur ka të drejtë vote në Komunën e Mamushës, mirëpo nga arsyetimi i goditur përmes kësaj ankese konstatohet fakti se një veprim të tillë procedural me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk e ka ndër marrë në mënyrën e duhur, pasi që përmes emailit të datës 23.03.2023 dërguar nga zyrtari P.R "Zyrtar i Lartë i bazës së të Dhënave" për Kryeshefin Ekzekutiv të Sekretariatit të KQZ-së ishte dëshmuar se ankuesi për zgjedhjet e vitit 2017, 2019 dhe 2021 ka qenë pjesë e listës votuese në Komunën e Suharekës, mirëpo komisioni në fjalë është dashur ta ketë parasysh faktin se azhurnimi i listës së votuesve lidhur me zgjedhjet e fundit lokale për vitin 2021 të mbajtura me datë 17.10.2021, logjikisht më së voni ka mundur të azhurnohet deri në të njëjtën datë, pra datën e mbajtjes së zgjedhjeve, kurse data e lëshimit të letërnjoftimit të ankuesit është e mëvonshme respektivisht data 13.12.2021, sikurse është i njohur fakti se marrëdhënia e punë lidhet për të ardhmen, madje edhe konkursi është shpallur me datë 31.01.2023, prandaj Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave e ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike pasi që nuk ka arritur të konstatoi saktë qendrën e votimit të ankuesit në kohën e aplikimit sipas konkursit të datës 31.01.2023.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 08/27-658-2023 të datës 17.05.2023 ka vepruar drejtë kur e ka aprovuar pretendimin ankimor të ankuesit se nuk ka qenë obligative njohja e gjuhëve të tjera zyrtare, pasi që sipas konkursit të datës 30.01.2023 për pozitën me shifër "KQZ-05/2023-Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve në Mamushë", në pikën 4 dhe 6 lidhur me kriteret e konkursit është përcaktuar si në vijim: "4. Shkathtësi të shkëlqyera në komunikim me gojë dhe me shkrim në njërën

nga gjuhët zyrtare; 6. Njohja e gjuhës tjetër zyrtare konsiderohet si përparësi", prandaj mbështetur mbi këtë konstatim del se nuk ka qenë obligative njohja e gjuhës turke në rastin konkret, madje në konkursin në fjalë nuk është kërkuar të paraqiten dëshmi për njohjen e gjuhës turke.

Prandaj, nga se u tha si më lartë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 08/27-658-2023 të datës 17.05.2023 përmes të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 19.04.2023, ka vepruar gabimisht pasi që nuk ka arritur të konstatoi drejtë gjendjen faktike lidhur me vendbanimin e ankuesit dhe listën votuese, sikurse arsyetimi i vendimit të goditur është kundërthënës me dispozitivin dhe në të njëjtën kohë edhe i mangët pasi që në arsyetim e aprovon apo e pranon si të bazuar pretendimin ankimor lidhur me kriterin e konkursit sa i përket gjuhës zyrtare ndërsa në dispozitiv e refuzon në tërsi ankesën e tij, kurse lidhur me pretendim sa i përket vendbanimit ndërlidhur me të drejtën e votës nuk e arsyeton mjaftueshëm, respektivisht nuk ka arritur të konstatoj dhe shpjegojë saktë gjendjen faktike sikurse është konstatuar edhe më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, prandaj mbështetur në dispozitat e nenit 52 nën paragrafi 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative sikurse përcaktohet: "1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ" Kolegji i Këshilli konstatoi se Vendimi me numër 08/27-658-2023 të datës 17.05.2023 i nxjerrë nga Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i KQZ-së është vendim i paligjshëm dhe si i tillë është shfuqizuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, ndërsa lënda e ankuesit është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave me rastin e rishqyrtimit dhe rivendosje së lëndës së ankuesit sipas ankesës së datës 19.04.2023, duhet të ndërmerret të gjithë veprimet e nevojshme sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit nenin 7 paragrafi 7.1.a të Ligji Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës theksohet së " 7.1 KQZ-ja mban Listën e Votuesve dhe siguron që Lista e Votuesve është e saktë dhe e azhuruar, dhe e njëjta përmban: a) ekstraktin më të vonë në dispozicion nga Regjistri Qendror Civil i të gjithë votuesve me të drejtë vote të cilët janë regjistruar si qytetar të Kosovës sipas Ligjit për Shtetësinë", me qëllim të konstatimit të saktë se cili ka qenë apo cili mund të jetë vendvotimi i ankuesit në momentin e aplikimit në konkursin e datës 31.01.2023, si dhe duhet të eliminoj apo marr përbazë vërejtjet e dhëna juridike nga pikëpamjet e këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.804/2023

Flakron Gashi


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit, Zyra Ligjore
- Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komisionin Qendror Zgjedhor, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.